

L I G J
Nr.8878, datë 15.4.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MINISTRISË
SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË
TURKE TË KOOPERIMIT NDËRKOMBËTAR (TIKA) TË REPUBLIKËS SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar (TIKA) të Republikës së Turqisë për mbarështimin e lopës së racës “Xhersej” dhe për nxitjen e krijimit të shoqatave të fermerëve të mbarështimit të gjedhit “Xhersej” në rajonin e Malësisë së Madhe dhe Shkodrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3309, datë 25.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PROTOKOLL

**BASHKËPUNIMI MIDIS MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE AGJENCISË TURKE TË KOOPERIMIT NDËRKOMBËTAR (TIKA) TË
REPUBLIKËS TURKE**

Mbi mbarështimin e lopës së racës xhersej dhe nxitjen e krijimit të shoqatës së fermerëve të gjedhit xhersej në rajonin e malësisë së madhe dhe Shkodrës

Neni 1

Palët

Palët e këtij Protokollit janë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë dhe Kryeministria Turke, Agjencia Turke e Kooperimit Ndërkombëtar (e quajtur TIKA).

Neni 2

Subjekti dhe objektivat

TIKA dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë do të bashkëpunojnë në realizimin e Projektit të përgatitur për ngritjen e sistemit të mbarështimit të gjedhit në përshtatje me kushtet e vendit në rajonin e Malësisë së Madhe dhe Shkodrës dhe do të organizojë fermerët e gjedhit në shoqata fermerësh.

Projekti do kërkojë përdorimin e plotë të potencialit gjenetik të tufës së gjedhit, shtimin e fitimeve në sektorin e mbarështimit të gjedhit dhe organizimin e rritësve në shoqata.

Neni 3
Detyrimet e TIKA-s

a) TIKA do emërojë një konsulent projekti për një periudhë, së paku 2 muaj në vit për kryerjen e detyrave të përcaktuara në Projekt.

b) TIKA do të mundësojë përgatitjen e një programi trainimi për 3 grupe rritësish me nga 10 persona për një periudhë 5-ditore për mbarëshkrimin e kafshëve, të ushqyerit e kafshëve, organizimin e shoqatave të fermerëve të gjedhit, sëmundjet e kafshëve dhe inseminimin artificial.

c) TIKA do të ngrejë programin kompjuterik të mbarëshkrimit dhe do të emërojë një ekspert për Shqipërinë dhe koordinimin e versioneve të tyre vjetore për një periudhë të shkurtër.

d) TIKA do të sigurojë një përkthyes për konsulentin e Projektit.

e) TIKA do të sigurojë mjetet, material për inseminimin artificial, detektorin e proteinës në qumësht (nëse është e nevojshme), material për matrikullimin e kafshëve, kovë për matjen e qumështit dhe kompjuter dhe program mbarëshkrimi.

Neni 4
Detyrimet e Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit

Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të emërojë një koordinator kombëtar shqiptar të Projektit për të punuar me konsulentin turk të Projektit ose vetëm dhe të autorizuar të drejtojë ekipin shqiptar të Projektit me përpikmëri, të monitorojë dhe të vlerësojë veprimtaritë.

b) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të mundësojë punësimin e personelit shqiptar të përcaktuar në pjesën e dokumentit të projektit për kontributin shqiptar të projektit (p.sh. shoferët, përkthyesit, sekretarë, ekspertë etj.) gjatë gjithë periudhës së Projektit.

c) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të sigurojë zyrat dhe ambientet në Tiranë dhe në rajonin ku projekti do të aplikohet.

d) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë koston e përkthimit dhe interpretimit dhe shpenzimet e komunikimit, si telefon, faks dhe internet.

e) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të mundësojë instalimin e sistemit kompjuterik, duke krijuar kushtet e nevojshme teknike dhe ligjore.

f) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë mirëmbajtjen e automjetit, riparimin dhe shpenzimet e karburantit.

g) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të inkurajojë ngritjen e një shoqate të veçantë rritësish që do të adaptojnë Projektin dhe do të bëjnë rregullimet e nevojshme ligjore.

h) Të gjitha inputet e siguruara nga TIKA në kuadrin e projektit do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet, tarifat etj., dhe do të mundësohet tërheqja e këtyre inputeve nga zyrat doganore shqiptare sa më shpejt të jetë e mundur dhe të bëhet e vlefshme për Projektin.

i) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit të pjesëmarrësve të takimit të vlerësimit të përcaktuar në kuadrin e projektit.

Neni 5
Institucionet ekzekutive

Institucionet që do të ekzekutojnë këtë Projekt janë: TIKA, në emër të Palës Turke, dhe Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit, në emër të Palës Shqiptare.

Neni 6
Detyrimet e përbashkëta

a) Zbatuesit e Projektit do të jenë në gjendje të bëjnë amendamentet e duhura gjatë periudhës së Projektit me pëlqimin e Palës tjetër.

b) Në fund të 2-vjeçarit të parë do të bëhet një vlerësim dhe do të vendoset nëse do të vazhdojë Projekti apo jo, në përputhje të rezultateve të këtij vlerësimi.

c) Konsulenti i projektit, i emëruar nga TIKA, dhe koordinatori kombëtar shqiptar i Projektit

do të përgatisin raporte progresive të detajuara çdo 6 muaj dhe do t'i prezantojnë ato autoriteteve shqiptare dhe TIKA-s.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Palët do të njoftojnë njera-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Protokolli do të hyjë në fuqi ditën e 30 marsit pas marrjes së njoftimit të fundit për plotësimin e këtyre procedurave.

Mosmarrëveshjet për çështjet e pasigluara në këtë Protokoll do të vendosen ndërmjet palëve.

Ky Protokoll është nënshkruar midis Kryeministrit të Turqisë, Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit të Shqipërisë në _____20001 në dy kopje në turqisht, shqip dhe anglisht të cilat janë të barasvlefshme.

Në rast mosmarrëveshjeje referohuni kopjes në anglisht.

Republika e Shqipërisë
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit

Agron Duka

Republika e Turqisë
President i Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar
Dr.Oner Kabasakal